



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS
KOMISIONI I ANKIMIT

Nr. 553/5 prot.

Tiranë, më 31.03.2023

VENDIM

Nr. 12 datë 31/03/2023

“Për shqyrtimin e ankimit të organizatës jofitimprurëse “Shërbimi Ligjor Falas Tiranë TLAS” ndaj Vendimit të Komisionit të Vlerësimit Nr. 7, datë 13.03.2023, për refuzimin e aplikimit për përfitimin e financimeve nga buxheti i shtetit për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti”

Komisioni i Ankimit i përbërë prej:

Z. Erjon Ndreca - Kryetar
Znj. Migena Kazdeda - Anëtar
Znj. Arsilda Mamica - Anëtar

asistuar nga Sekretariati Teknik, sot, me datë 31.03.2023, mori në shqyrtim ankimin administrativ, për refuzimin e aplikimit për përfitimin e financimeve nga buxheti i shtetit për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, të organizatës “*Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)*”, depozituar pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas me datë 21.03.2023, Nr. 553/4 Prot, me të dhënat e mëposhtme:

ANKUES: “*Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)*”, përfaqësuar nga znj. Raimonda Bozo, Drejtore Ekzekutive.

OBJEKTI: Ankimi ndaj Vendimit të Komisionit të Vlerësimit Nr. 7 , datë 13.03.2023, administruar nga DNJF, me Nr. 553/2 Prot, datë 13.03.2023, “*Për aplikimin për financim të Organizatës Jofitimprurëse “Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)”*”.

BAZA LIGJORE: Ligji Nr. 111/2017, datë 14.12.2017, “*Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti*”;
Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 110, datë 06.03.2019, “*Për përcaktimin e procedurave të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre*”;
Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të DNJF nr. 5, datë 18.01.2022, “*Për miratimin e metodologjisë mbi procedurat e financimit të Organizatave Jofitimprurëse të Autorizura nga Ministri i Drejtësisë*”, i ndryshuar me

Urdhri nr. 5/1, datë 28/12/2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Urdhri nr. 5 datë 18.01.2022”.

Komisioni i Ankimit, pasi shqyrtoi pretendimet e ankuesit që ndër të tjera kërkon “pranimin e ankimit duke e konsideruar si të padrejtë përjashtimin, pasi dokumenti i munguar është i publikuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së Tatimeve dhe se nuk u arrit të merrej me firmë në momentin e aplikimit”.

VËREN SE:

Referuar dokumentacionit të përcjellë në aplikimin e Organizatës Jofitimprurëse “Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)”, rezulton se Komisioni i Vlerësimit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve për financim të organizatave jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë, me Vendimin Nr. 7, datë 13.03.2023, **vendosi unanimisht refuzimin e aplikimit për financim.**

Pranë Komisionit të Ankimit në Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas me datë 21.03.2023, Nr. 553/4 Prot., është administruar ankimi i “Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)”, përfaqësuar nga znj. Raimonda Bozo, Drejtore Ekzekutive.

Kundër Vendimit të Komisionit të Vlerësimit Nr. 7, datë 13.03.2023, në ankimin e saj me shkrim znj.Bozo, përfaqësuese e “Shërbimit Ligjor Falas Tiranë (TLAS)”, ka parashtruar se:

- i. Përjashtimi nga vlerësimi i aplikimit të (TLAS) konsiderohet si i padrejtë pasi dokumenti i munguar është i publikuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së Tatimeve dhe nuk u arrit të merrej me firmë në momentin e aplikimit.

Në vijim të këtyre pretendimeve, ankuesi ka kërkuar “rivlerësimin e aplikimit duke bashkëngjitur me ankimin dhe pasqyrat e konfirmuara nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve”.

Rrethanat faktike të çështjes,

Pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas është administruar kërkesa e organizatës jofitimprurëse “Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)” protokolluar me Nr. 553 Prot., datë 01.03.2023, Organizata Jofitimprurëse ka aplikuar për financim nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti.

Bazuar në kriteret e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 110, datë 06.03.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre” si dhe Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të DNJF nr. 5, datë 18.01.2022, “Për miratimin e metodologjisë mbi procedurat e financimit të Organizatave Jofitimprurëse të Autorizuara nga Ministri i Drejtësisë”, i ndryshuar me Urdhri nr. 5/1, datë 28/12/2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Urdhri nr. 5 datë 18.01.2022” organizata ka përcjellë dokumentacionin e poshtëshënuar:

- Deklaratë për vlerësim donatorësh;
- Përcjellë pasqyra financiare e vitit 2021; (e pakonfirmuar nga DPT);
- ID e anëtarëve të organeve vendimmarrëse dhe përfaqësuesit ligjor të organizatës;



- Vërtetim nga prokuroria dhe gjykata se anëtarët e organeve vendimmarrëse dhe përfaqësuesit ligjor të organizatës nuk janë në proces hetimi apo gjykimi për çështje që çënojnë besimin e publikut dhe ofrimin e përshtatshëm të ndihmës juridike;
- Përcjellë formulari tip i deklaramit të konfliktit të interesit të punonjësve;
- CV e punonjësve të organizatës (*avokatë; jurist; financier dhe çdo punonjës tjetër që ka rol në plotësimin e objektivave të projektit*);
- Statuti i qendrës;
- Formulari tip i aplikimit;
- Kontratat e punës së punonjësve;
- Kontratë qeraje;
- Foto të pamjeve të ambientit ku ushtron veprimtarinë organizata;
- Deklarim mbi eksepriencën e punës së stafit që do të angazhohet në projekt;
- ID e Drejtorit Ekzekutiv;
- Vërtetim Gjyqësor nga Zyra e rregjistrimit të OJF-ve;
- Deklaratë tip mbi financimin e dyfishtë;
- Përcjellë inventari i paisjeve fizikë (*kompjuter; printera; tavolina; karrrike etj.*);
- Ofertë financiare;
- Deklaratë mbi numrin e qytetarëve të cilëve u kanë shërbyer me ndihmë juridike në bazë të ligjit 111/2017;
- Rekomandim për shërbimin ligjor falas;
- Vërtetim për statusin aktiv;
- Informacion bankar mbi numrin e llogarisë së organizatës;
- Vërtetim mbi detyrimet në kohë reale lëshuar nga DPT;
- Plani financiar i aktiviteteve/ logjistikës dhe pagesave;
- Autorizim “Për Ofrimin e Ndihmës Juridike Parësore” dhënë nga Ministri i Drejtësisë;
- Urdhri nr. 303, datë 10.09.2020, “Për autorizimin e Organizatës jofitimprurëse “Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)” në ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti“ i Ministrisë së Drejtësisë ;
- Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të deklaruara nga subjekti;
- Listëpagesa e kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të ardhurat nga punësimi;

Komisioni i Vlerësimit pas administrimit të dokumentacionit të dorëzuar përmes aplikimit të “Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)”, bazuar në Nenin 35 e vijues të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas”, të miratuar me Urdhër të Ministrisë Nr. 393, datë 23.11.2020, ka zhvilluar procedurat e mbledhjes së Komisionit dhe ka shqyrtuar dokumentacionin përkatës. Kjo referuar procesverbaleve të mbajtura nga Sekretariati Teknik pranë këtij Komisioni.

- Komisioni i Vlerësimit ka arsyetuar se: Pasqyrat Financiare të vitit të fundit të nënshkruara nga hartuesi i pasqyrave financiare dhe të nënshkruara nga drejtuesi i Organizatës, janë përcjellë të pakonfirmuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, duke vendosur përfundimisht refuzimin e aplikimit për financimin të Organizatës jofitimprurëse “Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)”.

Vlerësimi i Komisionit të Ankimit mbi procedurat e ndjekura në kuadër të aplikimit të “Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)”, për përfitimin e financimeve nga buxheti i shtetit

Në mbështetje të pikës 5 të VKM nr. 110, datë 6.3.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka ndërmarrë masat për publikimin në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të thirrjes për financimin e OJF-ve të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore (*Afati i aplikimit 31.01.2023-01.03.2023*):

- Buletini nr. 6, viti 2023: <https://qbz.gov.al/eli/bnjz/2023/6/95c6a821-3a21-4291-9c12-df4f471a4c24>

Gjithashtu, thirrja për financim është publikuar edhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, në rubrikën njoftime, si vijon:

- link: <https://drejtesia.gov.al/thirrjes-se-drejtorise-se-ndihmes-juridike-falas-per-financimin-e-organizatave-jofitimprures-te-autorizuara-per-ofrimin-e-ndihmes-juridike-paresore/>

Në këtë kuadër me qëllim trajtimin e aplikimeve të paraqitura në afatet e mësipërme, në zbatim të VKM Nr. 110, datë 06.03.2019, me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë Nr. 168 Prot., datë 13.02.2023, u ngrit Komisioni i Vlerësimit dhe i Ankimit.

Pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas është administruar kërkesa e organizatës jofitimprurëse “**Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)**”, protokolluar me Nr. 553 Prot., datë 01.03.2023, e cila rezulton e autorizuar nga Ministri i Drejtësisë i vlershëm për periudhën shtator 2022- shtator 2024. Kjo kërkesë rezulton e paraqitur brenda afatit të thirrjes (*Afati i aplikimit 31.01.2023-01.03.2023*).

Në vijim të trajtimit të këtij aplikimi, me Vendimin Nr. 7 datë 13.03.2023, Komisioni i Vlerësimit refuzoi aplikimin e organizatës jofitimprurëse “Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)”.

Vendimi Nr. 7, datë 13.03.2023, iu komunikua organizatës nëpërmjet shërbimit postar me Shkresën 553/3 Prot, me datë 13.03.2023. Sipas informacionit të marrë pranë shërbimit postar, organizatës i është komunikuar vendimi me datë 17.03.2023. Me shkresën e protokolluar pranë Drejtorisë me Nr. 553/4 Prot, datë 21.03.2023 organizata ka ushtruar të drejtën e ankimit. **Komisioni i Ankimit konstaton se ankesa e organizatës depozituar me Nr. 553/4 Prot., datë 21.03.2023, është bërë brenda afatit pesë ditor të parashikuar në pikën 16 të VKM-së Nr. 110, datë 06.03.20219.**

Komisioni i Ankimit duke u bazuar në procedurat e mësipërme, mbi dokumentacionin e depozituar nga organizata, parashtrimet e paraqitura në ankim, dhe vendimarrjen e Komisionit të Vlerësimit, konstanton se:

Bazuar në Pikën 2, të VKM Nr. 110, datë 06.03.2019, “Për përcaktimin e procedurave të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”, rezulton se procedurat e përfitimit të financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuara janë bërë duke u bazuar në parimet:

- a) konkurrueshmërisë;
- b) trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuara, aplikuese për përfitimin e financimit;

- c) transparencës të të gjitha fazave që lidhen me shqyrtimin, vendimmarrjen dhe përzgjedhjen e organizatave jofitimprurëse të autorizuara;
- ç) kriterëve të mirëpërcaktuara dhe publike, të cilat do të mundësojnë vlerësimin e propozimeve të organizatave jofitimprurëse të autorizuara në raport me objektivat dhe prioritetet e mbështetjes financiare;
- d) efektivitetit dhe ekonomizimit në shfrytëzimin e fondeve publike, duke siguruar që të arrihen objektivat dhe prioritetet e përcaktuara me një kosto sa më të favorshme për realizimin e shërbimit të synuar;
- dh) respektimit të plotë të parimeve të llogaridhënies dhe raportimit në përdorimet e fondeve publike;
- e) financimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore për kategoritë e përfitueseve që janë me prioritet për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas dhe në interes të përfituesve të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti;
- ë) ruajtjes së pavarësisë së organizatës jofitimprurëse të autorizuar;
- f) parandalimit të konfliktit të interesit, si dhe të çdo aktiviteti tjetër që rrezikon ofrimin me integritet të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

Në Pikën 6, shkronja “b”, iv), të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 110, datë 06.03.2019 përcaktohet shprehimisht se: *“Për t’u kualifikuar për të përfituar financime, organizatat jofitimprurëse të autorizuara duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, përfshirë këtu edhe kërkesa të tjera specifike që mund të jenë të nevojshme për ofrimin e ndihmës juridike parësore, sipas thirrjes publike të veçantë”*.

Këto kërkesa specifike janë përcaktuar në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të DNJF nr. 5, datë 18.01.2022, *“Për miratimin e metodologjisë mbi procedurat e financimit të Organizatave Jofitimprurëse të Autorizura nga Ministri i Drejtësisë”*, i ndryshuar me Urdhrin nr. 5/1, datë 28/12/2022, *“Për disa ndryshime dhe shtesa në Urdhrin nr. 5 datë 18.01.2022”*. të cilat lidhen me prioritetet e kërkuara dhe targetin për secilin prioritet.

Evidentohet se organizata në përputhje me Pikën 6 të VKM Nr. 110, datë 06.03.2019, *“Për përcaktimin e procedurave të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”*, ka depozituar dokumentacionin e kërkuar, referuar të cilit, Komisioni i Vlerësimit në analizë përmbajtësore ka konkluduar në mosplotësimin e kriterëve të veçanta.

Dokumentacioni i përcjellë nëpërmjet aplikimit të kryer nuk i përmbush kriteret e veçanta të përcaktuara në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të DNJF nr. 5, datë 18.01.2022, *“Për miratimin e metodologjisë mbi procedurat e financimit të Organizatave Jofitimprurëse të Autorizura nga Ministri i Drejtësisë”*, i ndryshuar me Urdhrin nr. 5/1, datë 28/12/2022, *“Për disa ndryshime dhe shtesa në Urdhrin nr. 5 datë 18.01.2022”*, për shkak se Pasqyrat Financiare nuk janë përcjellë në përputhje me Metodologjinë mbi procedurat e financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë.

Konkretisht, tek Kriteret e Veçanta të Metodologjisë, në kuadër të përmbushjes së projekt-propozimit, sipas pikës 8, Pasqyrat Financiare të vitit të fundit duhet të jenë të nënshkruara nga hartuesi i Pasqyrave Financiare dhe të nënshkruara nga drejtuesi i Organizatës, **të konfirmuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.**

Lidhur me pretendimin se vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit; “...konsiderohet si e padrejtë pasi dokumenti i munguar është i publikuar në faqen zyrtare të drejtorisë së Tatimeve dhe nuk u arrit të merrej me firmë në momentin e aplikimit...”, vlerësojmë se ky pretendim **nuk qëndron pasi** referuar Aneksit 1 (**Lista e dokumenteve të nevojshme për aplikim**) të Metodologjisë së miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të DNJF nr. 5, datë 18.01.2022, “Për miratimin e metodologjisë mbi procedurat e financimit të Organizatave Jofitimprurëse të Autorizura nga Ministri i Drejtësisë”, i ndryshuar me Urdhrin nr. 5/1, datë 28/12/2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Urdhrin nr. 5 datë 18.01.2022”, tek Kriteret e Veçanta (**Kapaciteti Financiar i Organizatës**) në pikën 8, përcaktohet se si dokument për tu dorëzuar: “Pasqyrat financiare të vitit të fundit të nënshkruara nga hartuesi i pasqyrave financiare dhe të nënshkruara nga drejtuesi i Organizatës, **duhet të jenë të konfirmuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve**”.

Rezulton se Organizata Jofitimprurëse “**Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)**” ka përcjellë pasqyrat financiare të vitit 2021, të firmosura vetëm nga Auditi, Drejtuesi dhe Financieri i Organizatës dhe **të pa konfirmuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, pra jo në formën e kërkuar sipas përcaktimeve të mësipërme.**

Ndërsa lidhur me dokumentacionin e përcjellë bashkëlidhur ankesës, sqarojmë se shqyrtimi i dokumentacionit plotësues nuk është në kompetencën e Komisionit të Ankimit parashikuar në pikën 16 të VKM-së Nr. 110, datë 06.03.2019. Për më tepër, ky dokumentacion është paraqitur jashtë afateve të përcaktuara në thirrjen e publikuar.

Gjithashtu, administrimi i dokumenteve plotësues në këtë fazë të procedurës administrative, do të përbënte shkelje të parimit të përcaktuar qartë në gjermën b) të pikës 2 të VKM Nr. 110, datë 06.03.2019; “*trajtimi i barabartë i organizatave jofitimprurëse të autorizuara, aplikuese për përfitimin e financimit*”.

Për sa i përket pretendimit se dokumenti nuk u arrit të merrej me firmë brenda afatit, vlerësojmë se ky pretendim është i paarsyeshëm në kushtet kur thirrja për financimin e OJF-ve të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore ka zgjatur për rreth 30 ditë (*Afati i aplikimit 31.01.2023-01.03.2023*), kohë mëse e mjaftueshme për administrimin e dokumentit në formën e kërkuar.

PËR KËTO ARSYE

Duke marrë në konsideratë faktin se bazuar në Pikën 16 të VKM-së Nr. 110, datë 06.03.2019, Komisioni i Ankimit ka në tagrin e tij vlerësimin e përputhshmërisë të procedurave të ndjekura nga Komisioni i Vlerësimit me parashikimet e këtij akti dhe jo themelin e vendimmarrjes.

Duke marrë në konsideratë faktin se ankimi i depozituar nga “**Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)**”, ka të bëjë me themelin e vendimmarrjes dhe jo me anën procedurale, konkludojmë se trajtimi i objektit të ankesës del jashtë tagrit të Komisionit të Ankimit.

Mbështetur në rrethanat e faktit, hapat proceduriale të pasqyruara më lart, Komisioni konstaton se procedurat janë ndjekur në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 110, datë 06.03.2019, “Për përcaktimin e procedurave të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga shteti, që përfitojnë

financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”; Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas”, të miratuar me Urdhrin e Ministrit Nr. 393, datë 23.11.2020, dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të DNJF nr. 5, datë 18.01.2022, “Për miratimin e metodologjisë mbi procedurat e financimit të Organizatave Jofitimprurëse të Autorizuara nga Ministri i Drejtësisë”, i ndryshuar me Urdhrin nr. 5/1, datë 28/12/2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Urdhrin nr. 5 datë 18.01.2022”.

Në këto rrethana, bazuar në Pikën 17 dhe 18, VKM Nr. 110, “Për përcaktimin e procedurave të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”, Komisioni i Ankimit unanimisht:

VENDOSI:

1. Mospranimin e ankimit të paraqitur nga Organizata Jofitimprurëse “**Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)**”.
2. Kopje e këtij vendimi t’i njoftohet Organizatës jo më vonë se dy ditë nga marrja e vendimit.
3. Ngarkohet Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas për njoftimin dhe publikimin e këtij vendimi sipas parashikimeve ligjore.
4. Kundër këtij vendimi ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative kompetente, brenda afateve të parashikuara në legjislacionit në fuqi.

KRYETAR
Erjon Ndreca

ANËTAR
Migena Kazdeda

ANËTAR
Arsilda Mamica

U shpall në Tiranë,
me datë 31.03.2023.

Ky vendim hartohet në 5 (pesë) kopje.